Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut

Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

MENDIM

Data e miratimit: 6 dhjetor 2012

Lënda nr. 10/08

Zvonimir RISTIÇ

kundër

UNMIK-ut

Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, i mbledhur më 6 dhjetor 2012,
me anëtarët vijues të pranishëm:

Z. Marek NOWICKI, Kryetar
Znj. Christine CHINKIN
Znj. Françoise TULKENS

Të ndihmuar nga
Z. Andrey ANTONOV, zyrtar ekzekutiv

Pas shqyrtimit të ankesës së sipërpërmendur, të paraqitur në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 të datës 23 mars 2006 për themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut,

Pas diskutimeve vendosi si në vijim:

I. PROCEDURA PRANË PANELIT

1. Ankesa u parashtrua më 5 maj 2008 dhe u regjistrua në të njëjtën ditë.

2. Më 10 qershor 2008, Paneli ia komunikoi ankesën Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP), për komentet e UNMIK-ut mbi pranueshmërinë dhe bazueshmërinë e ankesës. PSSP-ja e ofroi përgjigjen e UNMIK-ut më 3 tetor 2008.

3. Më 6 tetor 2008 Paneli ia dërgoi ankuesit komentet e UNMIK-ut dhe e ftoi atë të japë komentet e tij. Ankuesi nuk e shfrytëzoi këtë mundësi.

4. Më 15 maj 2009, Paneli kërkoi informacione shtesë nga ankuesi. Më 11 nëntor 2009, Paneli e mori përgjigjen e ankuesit.

5. Më 8 shkurt 2012, Paneli ia rikomunikoi ankesën PSSP-së për komente shtesë mbi pranueshmërinë. PSSP-ja e ofroi përgjigjen e UNMIK-ut më 19 mars 2012.

6. Me vendimin e 22 gushtit 2012, Paneli e shpalli ankesën të pranueshme pjesërisht . Më 7 shtator 2012, Paneli e informoi PSSP-në për këtë vendim dhe e ftoi UNMIK-un të bëjë komente shtesë për bazueshmërinë e ankesës.

7. Më 9 tetor 2012, PSSP-ja dha komentet e UNMIK-ut mbi bazueshmërinë.

II. FAKTET

8. Ankuesi është ish banor i Kosovës i cili aktualisht jeton në Serbi. Ai është pronar i një banese në Prishtinë, ku ai dhe familja e tij jetuan deri më 20 nëntor 1999, kur ata u detyruan të largohen nga Kosova për shkaqe sigurie. Më vonë ankuesi mësoi se banesa e tij ishte vjedhur dhe dëmtuar nga autorë të panjohur.

9. Më 23 gusht 2004, ankuesi parashtroi kërkesë për kompensimin e dëmit të shkaktuar në pronën e tij pranë gjykatës komunale të Prishtinës, kundër komunës së Prishtinës dhe Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ).

10. Kërkesa e tij bën pjesë në grupin e përafërsisht 17,000 kërkesave për kompensim të parashtruara në vitin 2004 pranë gjykatave të Kosovës, shumica prej tyre nga serbët e Kosovës, të cilët për shkak të luftës i kishin braktisur shtëpitë e tyre në Kosovë në vitin 1999 dhe prona e të cilëve më vonë ishte dëmtuar apo shkatërruar. Me qëllim të përmbushjes së afatit të parashkruar pesëvjeçar për paraqitjen e kërkesave civile për kompensim, këta ankues i parashtruan kërkesat e tyre rreth kohës së njëjtë në vitin 2004. Kërkesat u ishin drejtuar disave si UNMIK-ut, KFOR-it, IPVQ-ve dhe komunave përkatëse (shih Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (HRAP), *Milogoriç dhe të tjerët*, lëndët me nr. 38/08, 58/08, 61/08, 63/08 dhe 69/08, mendim i 24 marsit 2010, § 1; për bazën ligjore në të cilën ankuesit i bazuan kërkesat e tyre, shih mendimin e njëjtë § 5).

11. Lidhur me këto raste, Drejtori i Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut (DD) u dërgoi një shkresë të gjithë kryetarëve të gjykatave komunale dhe atyre të qarkut dhe kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës më 26 gusht 2004. Në atë shkresë, Drejtori i DD theksoi se ishin parashtruar "mbi 14,000" kërkesa të tilla. Ai iu referua "problemit që do të paraqiste një fluks kaq i madh i kërkesave për gjykatat", dhe kërkoi që "asnjë rast [i tillë] të mos caktohet për shqyrtim derisa bashkërisht të vendoset se si më së miri të procedohen këto raste" (për tekstin e plotë të shkresës, shih mendimin *Milogoriç dhe të Tjerët*, të cituar në § 10 lart, në § 6).

12. Më 15 nëntor 2005, DD ftoi gjykatat të fillojnë procedimin e kërkesave për dëmet e shkaktuara nga persona të identifikuar fizikë dhe për dëmet e shkaktuara pas tetorit 2000, duke konsideruar se "pengesat për procedimin efikas të këtyre rasteve" më nuk ekzistonin. Kërkesat që kishin të bënin me ngjarjet para tetorit 2000 nuk ndikoheshin nga kjo shkresë.

13. Më 22 shkurt 2007, gjykata komunale e Prishtinës, duke cituar Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/10 të 16 tetorit 2006 për zgjidhjen e kërkesave mbi pasurinë e paluajtshme private, duke përfshirë edhe tokën bujqësore dhe komerciale, konstatoi se Agjencia Kosovare e Pronës (AKP) kishte kompetente për të vendosur mbi kërkesën e ankuesit. Gjykata u deklarua jokompetente për këtë kontest. Sipas informacioneve të marra nga gjykata komunale, gjykata ia dërgoi dosjen e lëndës AKP-së në të njëjtën ditë.

14. Më 9 korrik 2007, ankuesi mori njoftimin për aktgjykimin e gjykatës komunale. Paneli nuk mund të vendosë për momentin nëse njoftimin e ka dërguar gjykata apo AKP-ja. Ankuesi thekson se ai ka parashtruar ankesë kundër këtij aktgjykimi brenda afatit pranë gjykatës së qarkut në Prishtinë, si gjykatë e shkallës së dytë, brenda periudhës së parashikuar kohore prej 15 ditësh, duke e dërguar shkresën e ankesës me postë të porositur në gjykatën komunale, ashtu siç kërkohet me dispozitat përkatëse të së drejtës procedurale. Mirëpo, nga 17 janari i vitit 2012 ai nuk ka dëgjuar asgjë lidhur me ankesën e tij.

15. Sipas informacioneve të marra nga AKP-ja, ai organ posedon kërkesën e ankuesit, sepse ajo i është referuar asaj nga gjykata komunale e Prishtinës. AKP-ja shpjegon se nuk ka ndërmarrë asnjë veprim lidhur me rastin, meqë asnjëherë nuk ka marrë njoftim nga gjykata e qarkut qoftë se vendimi i gjykatës komunale me të cilin lënda i referohet AKP-së është konfirmuar, ose se vendimi është anuluar dhe lënda i është kthyer gjykatës komunale.

16. Sipas rregullit, gjykata e gjakut në Prishtinë e informoi Panelin se lënda e ankuesit asnjëherë nuk ishte regjistruar në atë gjykatë.

17. Më 28 shtator 2008, Drejtori i DD informoi gjykatat që rastet të cilat nuk ishin caktuar për shqyrtim në pajtim me kërkesën e 26 gushtit 2004, të procedohen tani.

18. Më 9 dhjetor 2008, përgjegjësia e UNMIK-ut lidhur me gjyqësorin në Kosovë përfundoi me marrjen e kontrollit të plotë operacional nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) në fushën e sundimit të ligjit, pas deklaratës së bërë nga Kryetari i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara më 26 nëntor 2008 (S/PRST/2008/44), duke përshëndetur angazhimin e vazhdueshëm të Bashkimit Evropian në Kosovë.

III. ANKESA

19. Përderisa ankesa është shpallur e pranueshme, ankuesi në esencë pohon se procedura lidhur me ankesën e tij për pronën e dëmtuar është pezulluar, duke ia bërë të pamundur të merr vendim për ankesën e tij, duke shkelur të drejtën e tij për qasje në gjykatë sipas nenit 6 § 1 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Ai po ashtu ankohet se, si pasojë e pezullimit, procedura nuk është përfunduar brenda një kohe të arsyeshme, duke shkelur nenin 6 § 1 të KEDNJ.

V. LIGJI

A. Pohimi për shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNJ

Parashtresa e ankuesit

20. Ankuesi së pari i referohet vonesës së procedurës pranë gjykatës komunale të Prishtinës, e cila nuk vendosi për ankesën e tij kundër komunës së Prishtinës dhe IPVQ-ve për dy vite e gjysmë. Së dyti, ai ankohet për dështimin e gjykatës së qarkut të Prishtinës për të ndërmarrë veprim për ankesën e tij kundër vendimit të gjykatës komunale të Prishtinës.

21. Në këtë aspekt, siç u theksua lart, ai thirret në shkelje të së drejtës së tij për qasje në gjykatë dhe për të marrë vendim brenda një kohe të arsyeshme, ashtu siç është garantuar me nenin 6 § 1 të KEDNJ.

Parashtresa e UNMIK-ut

22. Në komentet e tij për bazueshmërinë e ankesës, PSSP-ja pohon se për aq sa të drejtat e mbrojtura me nenin 6 § 1 ishin të kufizuara në Kosovë, çdo kufizim ka qenë në pajtueshmëri me KEDNJ, meqë është ndjekur një qëllim legjitim ku ka pasur një proporcion të arsyeshëm në mes të mjeteve të përdorura dhe qëllimit që është kërkuar të arrihet.

23. PSSP-ja pranon se sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, vlerësimi i vonesave në procedurat gjyqësore duhet të bazohet në afatin kohor ndërmjet të parashtrimit të ankesës dhe momentit kur aktgjykimi nacional merr formën e prerë.

24. PSSP-ja parashtron se në rastin e ankuesit afati kohor për vlerësimin e çfarëdo vonese në procedurën gjyqësore është nga datat e parashtrimit të ankesës pranë gjykatës komunale të Prishtinës në gusht të vitit 2004 deri në kohën kur UNMIK-u ia dorëzoi EULEX-it përgjegjësitë e mbetura në fushën e drejtësisë, 9 dhjetor 2008.

25. PSSP-ja shton se pas shkresës së sipërpërmendur të DD të datës 15 nëntor 2005 (shih § 0 lart), gjykata komunale e Prishtinës vendosi për ankesën e ankuesit "shpejt pas kësaj" (më 22 shkurt 2007), që vetiu tregon se gjykata veproi me kujdes për zgjidhjen e ankesës.

26. PSSP-ja mendon se vonesa nga ana e gjykatës së qarkut në Prishtinë ishte për shkak të mosparashtrimit të ankesës në mënyrën e duhur nga ana e ankuesit pranë gjykatës, dhe më pas nga mosndërmarrja e hapave të mjaftueshëm proaktiv për rregullimin e situatës.

27. Prandaj, PSSP-ja konkludon se çështja ishte trajtuar nga autoritetet gjyqësore të Kosovës pa vonesë të paarsyeshme, dhe se vonesa e mëvonshme nga moskryerja e shkresave përkatëse nuk duhet t'i ngarkohet UNMIK-ut.

Vlerësimi i Panelit

1. Parimet e përgjithshme

28. Në pjesën përkatëse të nenin 6 § 1 të KEDNJ thuhet,

> "Në përcaktimin e të drejtave civile dhe obligimeve ..., çdokush ka të drejtë në dëgjim të drejtë …brenda një kohe të arsyeshme nga [një] ... tribunal ..."

29. Paneli përkujton se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës duhet të vlerësohet duke marrë parasysh rrethanat e rastit dhe duke ju referuar kritereve vijuese: ndërlikueshmërisë së rastit, sjelljes së ankuesit dhe autoriteteve relevante, dhe në çfarë aspekti është rrezikuar ankuesi në atë kontest (shih, në mesin e shumë autoriteteve të tjera, Gjykata Evropiane të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) (Grand Chamber), *Frydlender kundër Francës*, nr. 30979/96, aktgjykim i 27 qershorit 2000, GJEDNJ, 2000-VII, § 43; shih po ashtu Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (HRAP), *Emini*, nr. 17/08, mendim i 18 qershorit 2010, § 21; HRAP, *Mitroviç*, nr. 05/07, mendim i 17 dhjetorit 2010, § 85).

30. Gjithashtu, Paneli përkujton se KEDNJ u vë detyrim shteteve të organizojnë sistemin e tyre ligjor ashtu që gjykatave t'u mundësojnë të veprojnë në përputhje me kushtet e nenit 6 § 1, duke përfshirë edhe kushtin për gjykim "brenda një kohe të arsyeshme". Derisa një grumbullim i përkohshëm i punëve të gjykatës nuk e vë përgjegjësinë mbi autoritetet nëse ata ndërmarrin veprime përkatëse për rregullimin e gjendjes me shpejtësinë e nevojshme, një mbingarkesë kronike e lëndëve nuk mund të arsyetojë kohëzgjatjen e tepruar të procedurës (shih GJEDNJ, *Pammel kundër Gjermanisë*, nr. 17820/91, dhe *Probstmeier kundër Gjermanisë*, nr. 20950/92, aktgjykim i 1 korrikut 1997, *Raportet e aktgjykimeve dhe vendimeve*, 1997-IV, p. 1112, § 69 viz. f. 1138, § 64).

2. Zbatimi i parimeve të përgjithshme në rastin aktual

a. Periudha që duhet marrë parasysh

31. Ankesa e ankuesit u regjistrua nga gjykata komunale e Prishtinës më 23 gusht 2004. Kjo datë shënon fillimin e procedurës. Mirëpo, periudha që duhet marrë parasysh fillon nga data e juridiksionit kohor të Panelit, që është 23 prilli 2005. Gjatë vlerësimit të arsyeshmërisë së kohës që ka kaluar pas 23 prillit 2005, Paneli megjithatë do të marrë parasysh gjendjen e procedurës në atë moment (GJEDNJ, *Foti dhe të Tjerët kundër Italisë*, nr. 7604/76 dhe të tjerë, aktgjykim i 10 dhjetorit 1982, § 53, Publikime të gjykatës, Seria A, nr. 56, f. 15; GJEDNJ, *Styranowski kundër Polonisë*, nr. 28616/95, aktgjykim i 30 tetorit 1998, § 46, Raportet e aktgjykimeve dhe vendimeve, 1998-VIII, f. 3376).

32. Më 22 shkurt 2007, gjykata komunale e Prishtinës, e shpalli veten jokompetente për të vendosur për ankesën e ankuesit si gjykatë e shkallës së parë. Ankesa e ankuesit kundër këtij vendimi është akoma në pritje për shqyrtim pranë gjykatës së qarkut në Prishtinë. Pra konkludimi i Panelit është se ankesa e ankuesit është akoma në pritje për t'u zgjidhur.

33. Mirëpo, siç u tha më lart, më 9 dhjetor 2008, përgjegjësia e UNMIK-ut lidhur me gjyqësorin në Kosovë përfundoi (shih § 18 lart). Pra periudha nën shqyrtim përfundoi më 9 dhjetor 2008. Sa i përket periudhës prej 9 dhjetorit 2008, Paneli nuk mund të kontrollojë nëse procedura ishte në përputhje me kushtin për kohën e arsyeshme.

34. Kohëzgjatja e përgjithshme e procedurës, deri në momentin kur UNMIK-u nuk ishte më përgjegjës, ishte pra katër vite, tre muaj dhe pesëmbëdhjetë ditë, nga të cilat tri vite, shtatë muaj dhe pesëmbëdhjetë ditë duhet të shqyrtohen nga Paneli. Gjatë periudhës nën shqyrtim, lënda ishte në pritje pranë gjykatës komunale të Prishtinës, gjykatës së qarkut në Prishtinë dhe AKP-së.

b. Vlerësimi i arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës

35. Sa i përket ndërlikueshmërisë së rastit, Paneli thekson se kërkesa e ankuesit ishte njëra nga rreth 17,000 kërkesa të ngjashme, që së bashku krijuan probleme logjistike dhe probleme të tjera për gjykatat e Kosovës. Të gjitha këto kërkesa ngritën çështjen e vështirë të imunitetit të UNMIK-ut nga juridiksioni i gjykatave vendore, si dhe zbatueshmërinë e ligjit që autoritetet publike i bën përgjegjëse për vepra të caktuara që kryhen nga autorë të panjohur. Paneli pranon se, për shkak të karakteristikave specifike të këtyre kërkesave, kërkesa e ankuesit paraqiste ndërlikime të caktuara.

36. Paneli gjithashtu thekson se një pjesë e konsiderueshme e çështjes së ngritur nga ky rast i është parashtruar Panelit nga ankues të tjerë. Për shembull, Paneli përkujton se në rastet e bashkuara të *Milogoriç dhe të Tjerët* (cituar në § 10 lart), shqyrtoi ankesat e pesë ankuesve të cilët po ashtu ishin pronarë të pasurisë së paluajtshme në Kosovë. Në vitin 1999, duke u frikësuar nga lufta, ata po ashtu u larguan nga shtëpitë e tyre në Kosovë. Ngjashëm, prona e tyre u dëmtua apo u shkatërrua gjatë pjesës së dytë të vitit 1999, pas hyrjes së UNMIK-ut dhe KFOR-it në Kosovë. Në vitin 2004, këta ankues gjithashtu parashtruan ankesat e tyre kundër UNMIK-ut, KFOR-it, dhe IPVQ-ve dhe kundër komunave përkatëse pranë gjykatave përkatëse komunale, duke kërkuar kompensim për dëmin e shkaktuar pronave të tyre. Deri në kohën e parashtrimit të ankesave të tyre pranë Panelit, asnjëri nga ankuesit në këto raste nuk ishte kontaktuar nga gjykatat përkatëse dhe nuk ishin caktuar data për seanca dëgjimore.

37. Në rastin *Milogoriç dhe të Tjerët* Paneli konstatoi se "fakti që për një periudhë të gjatë kohore, ankuesit ishin të ndaluar që të marrin vendim për kërkesat e tyre për kompensim nga gjykatat, si pasojë e ndërhyrjes së DD, përbënte shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNJ", në mënyrë më specifike shkelje të së drejtës së tyre për qasje në gjykatë (HRAP, *Milogoriç dhe të Tjerët*, cituar lart, në § 46). Paneli po ashtu gjeti se "nuk [ishte] e nevojshme të shqyrtohet ndarazi çështja e kohëzgjatjes së procedurës" (mendim i njëjtë, në § 48).

38. Mirëpo, ndryshe nga rasti *Milogoriç dhe të Tjerët*, në këtë rast kërkesa e ankuesit për kompensim në fakt ishte shqyrtuar nga gjykata komunale e Prishtinës më 22 shkurt 2007, kur gjykata e shpalli veten jokompetente për të vendosur mbi kërkesën e ankuesit dhe lëndën ia referoi AKP-së. Prandaj, procedura gjyqësore në fakt ishte ndaluar për shkak të ndërhyrjes së lartcekur nga DD (shih § 11 lart) për dy vite e gjysmë, nga gushti 2004 deri në shkurt 2007.

39. Përkundër argumentit të PSSP-së se vendimi në fjalë i gjykatës komunale të Prishtinës ishte marrë pas shkresës së DD të datës 15 nëntor 2005 (shih § 0 lart), Paneli thekson se kërkesa e ankuesit nuk ishte e drejtuar kundër një individi të paidentifikuar, dhe prandaj nuk bën pjesë në kategorinë e atyre kërkesave të cilat gjykatat e Kosovës ftoheshin t'i procedojnë sipas asaj shkrese. Prandaj, Paneli e hedh poshtë këtë argument meqë nuk mund të zbathet për rastin aktual.

40. Sa i përket sjelljes së autoriteteve gjyqësore, Paneli thekson se historiku i lëndës mund të ndahet në dy periudha: periudha e parë nga parashtrimi i ankesës pranë gjykatës komunale më 23 gusht 2004 deri në marrjen e aktgjykimit nga gjykata komunale, të marrë më 22 shkurt 2007, dhe periudha e dytë nga parashtrimi i ankesës pranë gjykatës së qarkut kundër aktgjykimit deri në përfundim të përgjegjësisë së UNMIK-ut lidhur me gjyqësorin në Kosovë, 9 dhjetor 2009.

41. Lidhur me periudhën e parë, dy vite e gjashtë muaj kaluan ndërmjet marrjes së dosjes së lëndës nga gjykata komunale (më 23 gusht 2004) dhe ditën kur ajo e mori aktgjykimin më 22 shkurt 2007. Mirëpo, nga ajo kohë vetëm një vit e dhjetë muaj i përkasin periudhës për të cilën Paneli ka juridiksion (nga 23 prilli 2005). Paneli tanimë ka konstatuar se vonesa në procedurën gjyqësore për shkak të urdhrit të DD së UNMIK-ut, siç është rasti gjatë kësaj periudhe të parë, nuk është arsyetuar mjaftueshëm (shih *Milogoriç dhe të Tjerët*, cituar në § 10 lart, në § 46).

42. Megjithatë, edhe pse kemi të bëjmë me një pjesë të konsiderueshme të tërë periudhës aktualisht nën shqyrtim, Paneli nuk e konsideron këtë vonesë të paarsyeshme. Mirëpo, ky aktgjykim i gjykatës komunale nuk ishte akti i fundit në këtë procedurë sa i përket ankesës së ankuesit meqë ai paraqiti ankesë kundër këtij vendimi.

43. Duke ju kthyer periudhës së dytë, Paneli së pari konsideron se fakti se AKP-ja është në dijeni për ankesën e ankuesit kundër vendimit të gjykatës komunale (shih § 15 lart) përbën dëshmi të mjaftueshme për të konstatuar se ankesa e ankuesit nuk ka arritur tek autoritetet gjyqësore, që nga ai moment merrnin përgjegjësinë për të vendosur për ankesën e tij. Gjithashtu, në komentet e para lidhur me këtë ankesë, UNMIK-u u pajtua se rasti i ankuesit ishte akoma në pritje për t'u shqyrtuar nga gjykata e qarkut të Prishtinës. Prandaj, këto fakte Paneli i konsideron të mjaftueshme për të konstatuar se ankesa e ankuesit në mënyrën e duhur kishte arritur tek autoritetet gjyqësore. Ankuesi e mori vendimin e gjykatë komunale më 9 korrik 2007, prandaj Paneli në mënyrë të sigurt konsideron se ankesa e tij ishte parashtruar më 1 gusht 2007, e cila datë do të shfrytëzohet për shqyrtime të mëtejshme.

44. Paneli gjithashtu thekson se nga 1 gushti 2007 deri së paku 17 nëntor 2011 (data e komunikimit të fundit me Panelin) nuk është marrë asnjë veprim as nga gjykata e qarkut të Prishtinës për ankesën e ankuesit, as nga AKP-ja, në pritje të vendimit nga gjykata e qarkut. Mirëpo, vetëm koha deri më 9 dhjetor 2008 bën pjesë në periudhën për të cilën Paneli ka juridiksion, që është një vit, katër muaj e 10 ditë.

45. Sa i përket sjelljes së ankuesit, as nga informacionet e dosjes së lëndës as nga parashtresa e PSSP-së nuk duket se ankuesi duhet të jetë përgjegjës për vonesën e procedurës pranë gjykatës së shkallës së parë.

46. Sa i përket asaj se në çfarë aspekti ishte i rrezikuar ankuesi, Paneli e pranon se rasti ishte i një rëndësie të madhe për të. Ai u detyrua të largohet nga Kosova nga frika për jetën e tij, duke lënë pronën dhe posedimet e tij. Po të fitojë lëndën, ai do të fitonte një shumë të konsiderueshme si kompensim.

47. Paneli përkujton se ai kishte shqyrtuar dhe refuzuar shumicën e argumenteve të PSSP-së në *Milogoriç dhe të Tjerët* (cituar lart në § 10 lart) dhe në *Berisha dhe të Tjerët* (HRAP, nr. 27/08 dhe të tjerë, mendim i 23 shkurtit 2011, § 24). Paneli konstatoi se karakteri i përkohshëm i UNMIK-ut dhe vështirësitë e lidhura me të duhet të merren parasysh, por se në asnjë rrethanë këto elemente nuk duhet të merren si arsyetim për uljen e standardeve për respektimin e të drejtave të njeriut, të cilat janë inkorporuar në mandatin e UNMIK-ut (*Milogoriç dhe të Tjerët*, cituar në § 10 lart, në § 44; *Berisha dhe të Tjerët*, § 25).

48. Lidhur me argumentin e PSSP-së se ankuesi nuk ka kërkuar të mësojë për përparimin e bërë në lëndën e tij në gjykatën përkatëse, Paneli tashmë e ka refuzuar këtë argument në *Laliç dhe të Tjerët* (HRAP, lëndët me nr. 30/08 dhe të tjerë, mendim i 13 majit 2011, §

21). Paneli gjeti se ankuesit nuk mund të fajësoheshin për mosparashtrimin e pyetjeve në gjykatat përkatëse lidhur me përparimin e bërë në lëndët e tyre (*Laliç dhe të Tjerët* § 25).

49. Paneli nuk sheh arsye t'u shmanget të gjeturave të tij në rastet e *Milogoriç dhe të tjerët* dhe *Berisha dhe të Tjerët*.

3. Konkludim

50. Nga pikëpamja e asaj që u tha më lart, duke marrë periudhën brenda juridiksionit të Panelit lidhur me procedurat pranë gjykatës komunale të Prishtinës dhe ankesën drejtuar gjykatës së qarkut në Prishtinë, Paneli ka gjetur se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNJ për mosdhënien e mundësisë ankuesit që ankesa e tij të zgjidhet përfundimisht nga autoritetet kompetente dhe lidhur me kohëzgjatjen e procedurës.

B. Pohimi për shkelje të nenit 13 të KEDNJ

Parashtresat e palëve

51. Ankuesi i referohet dështimit të vazhdueshëm të gjykatës së qarkut në Prishtinë që të ndërmerr veprime për ankesën e tij.

52. Nga ky aspekt, ai thirret në shkelje të së drejtës së tij për mjet të efektshëm kundër dështimit të gjyqësorit për të vendosur për rastin e tij brenda një kohe të arsyeshme, të garantuar me nenin 13 të KEDNJ.

53. UNMIK-u nuk ka dhënë komente specifike lidhur me nenin 13.

Vlerësimi i Panelit

1. Parimet e përgjithshme

54. Në pjesët relevante të nenit 13 të KEDNJ thuhet,

> "Çdokush të drejtat e të cilit shkelen ... ashtu siç është paraparë në këtë Konventë, kanë të drejtë në mjet efikas pranë një autoriteti nacional ..."

55. Paneli përkujton se çështjet sipas neneve 6 dhe 13 të KEDNJ zakonisht puthiten dhe se Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut disa herë ka potencuar se kushtet e nenit 13 janë të përvetësuara dhe më pak strikte se ato të nenit 6, duke konstatuar se nuk ka nevojë të gjykohet nëse ka pasur shkelje të veçantë të nenit 13 (shih, p.sh. GJEDNJ, *Kamasinski kundër Austrisë*, nr. 9783/82, aktgjykim i 19 dhjetorit 1989, § 110, Seria A, nr. 168 (1991), 33 KEDNJ 36). Qasja e njëjtë është miratuar nga Paneli në raste të ngjashme me rastin aktual (shih *Milogoriç dhe të Tjerët*, të cilëve ju referuam lart).

56. Situatat ku Gjykata Evropiane mendon se është e nevojshme të bëhet shqyrtim i ndarë i çështjes sipas nenit 13 të KEDNJ janë të lidhura me kohëzgjatjen e tepërt të procedurës. Mirëpo, nuk përjashtohet mundësia se mund të ketë situata kur neni 13 do të duhet të shqyrtohet në një kontekst tjetër.

57. Paneli konstaton se në këtë rast të veçantë pohimi për shkelje sipas nenit 13 të KEDNJ ka nevojë të shqyrtohet në mënyrë të ndarë.

2. Zbatimi i parimeve të përgjithshme për rastin aktual

58. Paneli tashmë ka konstatuar se ankesa e ankuesit duhet të konsiderohet se është parashtruar pranë gjykatës së qarkut në Prishtinë deri më 1 gusht 2007 më së voni. Gjithashtu është konstatuar se gjykata që atëherë nuk e ka shqyrtuar ankesën e tij.

59. Kjo qasje arsyetohet me faktin se dështim i gjykatës së qarkut të Prishtinës për të vendosur mbi ankesën e ankuesit jo vetëm se e ndalon atë në marrjen e vendimit gjyqësor të formës së prerë në sistemin e rregullt të gjykatave, por edhe e ndalon AKP-në marrjen e vendimeve adekuate për këtë çështje.

60. Ky dështim i gjykatës së qarkut në Prishtinë ka dy pasoja. Së pari, për shkak të dështimit të gjykatës për të vendosur për ankesën e ankuesit nuk ka pasur vendim të formës së prerë për ankesën e ankuesit të parashtruar fillimisht pranë gjykatës komunale të Prishtinës. Së dyti është se AKP-ja nuk ishte në gjendje (dhe ende nuk është) të procedojë kërkesën e ankuesit pa vendimin e gjykatës së qarkut për ankesën e vendimit me të cilin kërkesa e tij ju referua AKP-së.

61. Në komentet e tij për këtë çështje, UNMIK-u nuk i tregoi Panelit se ka pasur mjet në dispozicion për ankuesin ku ai do të kishte pasur mundësi të trajtojë këtë situatë, në periudhën kohore që është nën shqyrtim të Panelit.

3. Konkludim

62. Paneli konstaton se ka pasur shkelje të së drejtë së ankuesit për mjet të efektshëm të garantuar me nenin 13 të KEDNJ.

VI. REKOMANDIMET

63. Duke pasur parasysh të gjeturat e Panelit në këtë rast, Paneli është i mendimit se një formë e reparacionit është i nevojshëm.

64. Natyrisht UNMIK-u është ai i cili duhet të merr masa adekuate për t'i dhënë fund shkeljes së theksuar dhe për të kompensuar efektet e saj sa më shumë që të jetë e mundur. Mirëpo, siç ka theksuar Paneli lart, përgjegjësia e UNMIK-ut lidhur me gjyqësorin në Kosovë përfundoi më 9 dhjetor 2008, me marrjen e kontrollit të plotë operacional nga EULEX-i në fushën e sundimit të ligjit. Prandaj, UNMIK-u nuk është më në pozicion të merr masa që do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në procedurën që është në pritje për shqyrtim nga autoritetet kompetente.

65. Paneli konsideron se kjo situatë faktike nuk e liron UNMIK-un nga obligimi i tij për të kompensuar sa më shumë që është e mundshme efektet e shkeljeve për të cilat është përgjegjës.

66. Lidhur me ankesat dhe lëndën, Paneli konsideron se është e duhur që UNMIK-u:

- Në pajtim me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në situatat kur kemi juridiksion të zvogëluar të shtetit, Paneli është i mendimit se UNMIK-u duhet të bëjë përpjekje, me të gjitha mjetet diplomatike që i ka në dispozicion *vis-à-vis* autoriteteve të Kosovës, të merr garanci se lënda e parashtruar nga ankuesi do të procedohet sipas rregullit (shih GJEDNJ (Grand Chamber), *Ilaşcu dhe të Tjerët kundër Moldavisë dhe Rusisë*, nr. 48787/99, aktgjykim i 8 korrikut

2004, § 333, *ECHR*, 2004-VII dhe *Al-Saadoon dhe Mufdhi kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 61498/08, aktgjykim i 2 marsit 2010, § 171; krahaso HRAP, *Milogoriç dhe të Tjerët*, cituar në § 10, lart, në § 49).

- Duhet të ndërmerr hapa adekuat për kompensim përkatës të ankuesit për dëmet jomateriale që i ka pësuar si pasojë e pezullimit të zgjatur të procedurës së iniciuar nga ai.

67. Paneli gjithashtu konsideron se është e duhur që UNMIK-u duhet të bëjë përpjekje të nxisë autoritetet kompetente në Kosovë të ndërmarrin të gjitha hapat e mundshëm për të siguruar që çdo individ që ka pësuar si pasojë e vonesës në administrimin e drejtësisë të ketë në dispozicion një mjet të efektshëm në kuptim të nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli unanimisht,

KONSTATON SE KA PASUR SHKELJE TË NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT PËR MOSOFRIMIN E MUNDËSISË ANKUESIT PËR TË MARRË VENDIM PËR ANKESËN E TIJ NGA GJYKATAT DHE LIDHUR ME KOHËZGJATJEN E PROCEDURËS;

KONSTATON SE KA PASUR SHKELJE TË NENIT 13 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT LIDHUR ME MUNGESËN E NJË MJETI TË EFEKTSHËM.

REKOMANDON QË UNMIK-U:

a. TË NXISË AUTORITETET KOMPETENTE NË KOSOVË TË NDËRMARRIN TË GJITHA HAPAT E NEVOJSHËM PËR TË SIGURUAR QË LËNDA E ANKUESIT TË VENDOSET PA VONESË TË MËTUTJESHME;

b. **TË NDËRMARRË HAPA ADEKUAT PËR KOMPENSIM ADEKUAT TË ANKUESIT PËR DËME JOMONETARE;**

c. **TË NXISË AUTORITETET KOMPETENTE NË KOSOVË TË NDËRMARRIN TË GJITHA HAPAT E NEVOJSHËM PËR TË SIGURUAR QË ÇDO INDIVID QË KA PËSUAR SI PASOJË E VONESËS NË ADMINISTRIMIN E DREJTËSISË TË KETË NË DISPOZICION NJË MJET TË EFEKTSHËM NË KUPTIM TË NENIT 13 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT;**

d. TË NDËRMARRË MASA TË MENJËHERSHME DHE EFEKTIVE PËR IMPLEMENTIMIN E REKOMANDIMEVE TË PANELIT DHE TË INFORMOJË ANKUESIN DHE PANELIN PËR ZHVILLIMET E MËTEJSHME NË KËTË RAST.

Andrey ANTONOV
Zyrtar ekzekutiv

Marek NOWICKI
Kryetar